



## Periodiku AMF

### Zhvillohet ceremonia e dhënies së diplomave aktuarëve profesionistë

Në datën 25 maj 2011, në ambientet e hotel “Rogner Europapark”, Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me F SVC dhe USAID, zhvilluan ceremoninë e dhënies së diplomave katërmbëdhjetë aktuarëve profesionistë.

*Vijon në faqen 2*

### Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-prill 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar-prill 2011 arritën shifrën 2,938,597 mijë lekë, përkundëjt 2,715,396 mijë lekë të realizuara në janar-prill 2010 ose 8.22% më shumë.

*Vijon në faqen 3*

### Ngjarje dhe zhvillime të tjera Zhvillohet konferenca rajonale 2011 mbi sigurimin e detyrueshëm motorik

Komisioni i Mbiqëqyrjes Financiare të Bullgarisë (BFSC), në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimeve të Bosnje Hercegovinës (IAB&H), zhvilluan më 19 maj, në Sarajevë, konferencën rajonale 2011 mbi sigurimin e detyrueshëm motorik.

*Vijon në faqen 5*

### Zhvillohet programi mbi stabilitetin financiar

Banka Qendrore e Holandës zhvilloi gjatë periudhës 16-18 maj në Amsterdam, Holandë, programin mbi stabilitetin financiar. Objekti kryesor i prezantimeve, mbajtur kryesisht nga përfaqësues të Bankës Qendrore të Holandës, përfaqësues të sektorit privat (ING) dhe organizmat Evropiane, ishte stabiliteti financiar i një vendi dhe qasja e autoriteteve rregullatore për të mbështetur stabilitetin.

*Vijon në faqen 5*

### Zhvillohet seminari rajonal mbi sfidat në harmonizimin e legjisllacionit dhe mbikëqyrjes kombëtare të sigurimeve, me kërkesat rregullatore të BE-së

Agjencia e Mbiqëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, zhvilloi gjatë periudhës 30 - 31 maj në Ohër, Maqedoni, seminarin rajonal mbi sfidat në harmonizimin e legjisllacionit dhe mbikëqyrjes kombëtare të sigurimeve, me kërkesat rregullatore të

BE-së. Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore të rajonit.

*Vijon në faqen 6*

### Zhvillohet konferenca ndërkombëtare mbi sistemet informative mbikëqyrëse “TI, masat, metodat e mënyrat e matjes së sigurisë informative”

Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare të Estonisë (FSA Estonia), zhvilloi gjatë periudhës 5-6 maj, në Tallinn, Estoni, konferencën ndërkombëtare mbi sistemet informative mbikëqyrëse “TI, masat, metodat e mënyrat e matjes së sigurisë informative”.

*Vijon në faqen 7*

### Informacion mbi të rejat në tregjet e rajonit Krijohet shoqëria e re e sigurimit të jetës në Maqedoni, Uniqa Life Macedonia

Shoqëria e Sigurimit Uniqa ka krijuar një shoqëri të re sigurimi jete, **Uniqa Life Macedonia**, e cila do të ofrojë produktet e sigurimit të jetës në tregun e Maqedonisë.

*Vijon në faqen 8*

### Edukimi i konsumatorit Metodikë për identifikimin e institucioneve me peshë në sistemin financiar (Systemically Important Financial Institutions-SIFI) në fushën e sigurimeve

*Kontribut për diskutimet e Bordit të Stabilitetit Financiar dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Mbiqëqyrësve të Sigurimeve*

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e Shoqatës së Gjenevës “The Geneva Association”, prill 2011)*

*Vijon nga numri I kaluar..*

### 4. Qasja e propozuar

Në këtë kapitull prezantohet qasja e Shoqatës së Gjenevës, e mbështetur nga sektori i sigurimeve, për të sqaruar ndërlidhjen midis rregullimit makro dhe mikro, në mënyrë që të identifikohen aktivitetet që mund të mbartin risk për sistemin dhe në një fazë të dytë të identifikohen institucionet financiare të rëndësishme për sistemin të cilat i kryejnë këto aktivitete (siç ilustron në tabelën e mëposhtme).

*Vijon në faqen 8*

## Në këtë numër:

Zhvillohet ceremonia e dhënies së diplomave aktuarëve profesionistë

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

5

Edukimi i konsumatorit

8

## Zhvillohet ceremonia e dhënies së diplomave aktuarëve profesionistë



Zj. E. Gjoni, në fjalën e saj përshëndetëse, gjatë ceremonisë së dhënies së diplomave aktualëve profesionistë



Aktuarët profesionistë gjatë marrjes së diplomave

Në datën 25 maj 2011, në ambientet e hotel "Rogner Europapark", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me FSVC dhe USAID, zhvilluan ceremoninë e dhënies së diplomave katërmëdhjetë aktuarëve profesionistë.

Në fjalën e saj, Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së, vlerësoi rëndësinë e klasave të profesionistëve të vërtetë, mbështetur në parime, kode të profesionit, njohuri bashkëkohore dhe

përvojë në sektorin financiar, të cilat janë reflektuar më së miri në mbështetjen që AMF ka dhënë në vazhdimin drejt rrugës se nisur të formimit të profesionit të aktuarit në Shqipëri.

Z. Joseph Williams, Shefi i misionit të USAID në Shqipëri; Zj. Leah McFarland, Drejtoreshë e FSVC-së dhe Z. Neil Hillary, Staff Actuary pranë Institutit Britanik të Aktuarëve, vunë theksin në rëndësinë e bashkëpunimit mes këtyre institucioneve dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, bashkëpunim pa të cilin programi nuk do të ish zhvilluar dot, si dhe përgëzuan aktuarët e rinj për përkushtimin me të cilin përballuan vështirësinë e kursit profesional.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare shprehu gatishmërinë dhe vullnetin për të rritur dhe zhvilluar këtë profesion në nivele më të larta, bazuar në parimet, normat e përcaktuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Aktuarëve. Në vijim të këtij procesi, AMF inkurajon dhe mbështet aktivitetin e shoqatës profesionale të aktuarëve. Kjo shoqatë duhet jetë me aktive dhe të ketë synime dhe objektiva të qarta për krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e profesionit të aktuarit në Shqipëri, për promovimin e prestigjit të tij, zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të unifikuara profesionale dhe anëtarësimin në organizatat profesionale ndërkombëtare.

AMF do të mbështetet në opinionet, rekomandimet dhe shërbimet e dhëna nga profesionistët e rinj në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare në Shqipëri me parimet bashkëkohore dhe do të mbështesë ata në kryerjen e të gjitha angazhimeve që i shërbejnë zhvillimit të sektorit financiar në Shqipëri, rritjes së efektivitetit të biznesit dhe mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Presidenti i parë i Shoqatës së Aktuarëve Shqiptarë, prof. Llukan Puka, falënderoi gjithë institucionet e përfshira për mbështetjen e treguar në zhvillimin e profesionit, kursantët për

përkushtimin dhe punën e kryer, si dhe shprehu besimin tek e ardhmja e profesionit të aktuarit në Shqipëri e rëndësinë që zgjerimi i këtij profesioni ka për mbarë tregun financiar kombëtar.

Në përfundim u shpërndanë diplomat katërbëdhjetë aktuarëve profesionistë.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-prill 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar-prill 2011 arritën shifrën 2,938,597 mijë lekë, përkundrajt 2,715,396 mijë lekë të realizuara në janar-prill 2010 ose 8.22% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 56.66% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 43.34% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 48.54% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 4.35% të sigurimeve të Jo-Jetës. 87.97% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 12.03% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës.


Në janar-prill 2011 u nënshkruan rreth 408,433 kontrata sigurimi, ose rreth 115.47% më shume se në janar-prill 2010.



### Volumi i primit të shkruar bruto, janar-prill (2010-2011)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2010	2011
<b>Janar-Prill</b>		
A) Sigurim i Jetës	238,025	353,555
B) Sigurim i Jo-Jetës	2,477,371	2,585,041
a) Sigurimi i Detyrueshëm	1,277,931	1,273,443
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,199,440	1,311,599
C) Risigurimi	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>2,715,396</b>	<b>2,938,597</b>

### Volumi i primit të shkruar bruto, janar-prill 2011 (Jeta dhe Jo-Jeta)



### Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-prill 2011, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 43.34% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-prill 2011, arritën 738,327 mijë lekë, ose 21.54% më pak se në janar-prill 2010.

Në janar-prill 2011, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 465,698 mijë lekë, ose rreth 77.45% më shumë se në janar-prill 2010.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-prill 2011 arritën në 69,417 mijë lekë, apo 6.83% më pak se në janar-prill të 2010.

### Sigurimet vullnetare

Në janar-prill 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,665,154 mijë lekë, ose 15.84% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.


Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,311,599 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 31.33% të pasuara nga, sigurimi kasko me 15.10% dhe nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 11.57% peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-prill 2011, arritën në 336,190 mijë lekë, 157.18% më shumë se në janar-prill 2010. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 90.34% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar-prill 2011 arritën në 353,555 mijë lekë, ose rreth 48.54% më shumë se në janar-prill 2010. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

### Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 36.33% të





Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 48.72% të primeve.

**Dëmet**

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-prill 2011 kapi vlerën 683, 268 mijë lekë, ose 8.04% më shumë se në janar-prill 2010. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 510,118 mijë lekë, apo 74.66% të totalit.

**Ngjarje dhe zhvillime të tjera**

**Zhvillohet konferenca rajonale 2011 mbi sigurimin e detyrueshëm motorik**

Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë (BFSC), në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimeve të Bosnje Hercegovinës (IAB&H), zhvilluan më 19 maj, në Sarajevë, konferencën rajonale 2011 mbi sigurimin e detyrueshëm motorik.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua në këtë konferencë nga Kryetarja, Zj. Elisabeta Gjoni dhe Zj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit Juridik. Konferenca u zhvillua në kuadrin e projektit të binjakëzimit të rregullatorëve të sektorit të sigurimeve të

Bullgarisë dhe Bosnje & Hercegovinës: “Ndërtimi i kapaciteteve mbështetëse të IAB&H dhe BFSC”, projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian për autoritetet e lartpërmendura në lidhje me ndërtimin e fuqizimin e kapaciteteve njerëzore mbështetëse në sektorin e sigurimeve. Konferenca mbledhi zyrtarë të lartë nga autoritete mbikëqyrëse të fushës së MTPL-së dhe ekspertë nga rajoni i Ballkanit Juglindor dhe Evropës Perëndimore, ekspertë të industrisë së sigurimeve, si dhe përfaqësues nga autoritete të ndryshme në Bosnje Hercegovinë.

Gjatë konferencës u diskutuan:

- o aspektet rajonale të Bashkimit Evropian të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- o tendencat dhe problemet e përjetuara nga pjesëmarrësit e tregut dhe institucionet publike për këto probleme;
- o zgjidhjet e zhvilluara për t’ju adresuar problemeve të zbuluara, si dhe njohjet me praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe;
- o çështjet e mbrojtjes konsumatore.

Çështjet e mësipërme, të trajtuara gjatë konferencës, kishin të bënin me:

- o kuadrin institucional të TPL-së;
- o çështjet e makinave të pasiguruara dhe masat e marra për parandalimin e tyre;
- o tranzicionin nga primi i aprovuar i TPL-së tek çmimi i liberalizuar, si dhe;
- o kriteret dhe kërkesat për t’ju bashkuar Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit.

Konferenca shërbeu për të lehtësuar shkëmbimin e eksperiencave midis rregullatorëve në këtë fushë, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi çështjet e MTPL-së, inkurajimin e gjetjeve të zgjidhjeve në përputhje me standardet dhe direktivat e BE-së, si dhe një mundësinë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal.

**Zhvillohet programi mbi stabilitetin financiar**  
Banka Qendrore e Holandës zhvilloi gjatë

periudhës 16-18 maj në Amsterdam, Holandë, programin mbi stabilitetin financiar.

Objekti kryesor i prezantimeve, mbajtur kryesisht nga përfaqësues të Bankës Qendrore të Holandës, përfaqësues të sektorit privat (ING) dhe organizmat Evropiane, ishte stabiliteti financiar i një vendi dhe qasja e autoriteteve rregullatore për të mbështetur stabilitetin. Vlerësimi i risqeve, analizat dhe instrumentet makroprudenciale, metodat e përcaktimit të institucioneve me peshë në treg, që rrisin rrezikun sistemik, testi i stresit dhe instrumentet që mund të përdoren në kohë krize, përbënin çështjet që u trajtuan në këtë aktivitet. Prezantimet paraqisnin përvojën holandeze, si dhe pikëpamjen e organizmave evropiane.

Përvoja e prezantuar u përqendrua në mësimet kryesore të marra nga kriza financiare globale që nisi më 2008 dhe nevoja për të reaguar me kohë.

Ajo ç'ka u theksua është se kriza financiare është një fenomen që nuk mund ta kontrollojmë apo ta shmangim. Por autoritetet rregullatore duhet të përgatiten për të patur në dorë instrumentet e nevojshme për zbutjen e ndikimit të krizave. Për pasojë, po kërkohet më shumë vëmendje ndaj risqeve dhe analizave në nivel makro. Konkretisht kërkohet:

- o Rritja e bashkëpunimit të autoriteteve rregullatore brenda vendit dhe midis vendeve. Për këtë arsye, u theksua rëndësia e kolegjeve të mbikëqyrjes; bashkëpunimi për menaxhimin e krizave, si dhe u shpjegua nevoja dhe për koordinim në nivel evropian.
- o Nevoja për rritje të rezervave mbrojtëse në kapital në përgjigje të analizës së rreziqeve sistematike dhe rezultateve të testit të stresit.
- o Nevoja për të identifikuar institucionet financiare të rëndësishme (me peshë) nga pikëpamja sistematike, me synim reduktimin e dëmit moral në sistemin financiar.
- o Nevoja për të riorganizuar bazën e të dhënave dhe shpërndarjen e informacionit financiar, me

synim që të reagohet në kohë me vendimmarrje të informuar.

- o Nevoja për t'i kushtuar vëmendje ciklit financiar dhe për të përdorur instrumentete financiare, me synim zbutjen e ciklit financiar për të reduktuar efektet e krizave.
- o Nevoja për t'i kushtuar vëmendje likuiditetit.

Në tërësi u theksua që, megjithëse kriza preku më së shumti sistemin bankar dhe kuadri i analizave dhe i përgjigjeve është hartuar për sistemin bankar, nuk ka asnjë garanci që fenomeni i krizës nuk prek dhe sektorët e tjerë të sistemit financiar. Për pasojë, skemat e analizës së risqeve, të testit të stresit, të identifikimit të institucioneve me peshë sistematike, si dhe instrumentet me të cilët mund të përgjigjesh, po shtrihen edhe në fushën e sigurimeve dhe të sektorëve të tjerë të sistemit financiar.

### **Zhvillohet seminari rajonal mbi sfidat në harmonizimin e legjislacionit dhe mbikëqyrjes kombëtare të sigurimeve, me kërkesat rregullatore të BE-së**

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, zhvilloi gjatë periudhës 30-31 maj në Ohër, Maqedoni, seminarin rajonal mbi sfidat në harmonizimin e legjislacionit dhe mbikëqyrjes kombëtare të sigurimeve, me kërkesat rregullatore të BE-së. Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore të rajonit.

Temat kryesore, u prezantuan nga drejtues të nivelit të lartë të IAIS-it (Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve), si dhe drejtues të agjencive të mbikëqyrjes së sigurimeve në rajon. Prezantimet kishin të bënin kryesisht me: arkitekturën e re të mbikëqyrjes në EU dhe rolin e EIOPA-s, (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Vullnetare), sfidat me të cilat përballen vendet e rajonit për zbatimin e direktivës së Solvency II, mbikëqyrjen me bazë risku, kërkesat në lidhje me treguesit sasiorë të Solvency II dhe mbrojtjen e konsumatorit.



Gjatë Seminarit u prezantua historiku i reformës në strukturën e mbikëqyrjes së sektorit financiar në EU pas krizës financiare të viteve 2007 dhe 2008, i cili u finalizua me ngritjen e EIOPA-s në janar 2011. Në seminar u prezantua gjerësisht struktura, roli, objektivat, përgjegjësitë kryesore, dhe mjetet që do të përdorë ky Autoritet në arritjen e objektivave.

U prezantua Solvency II, si programi më i madh i ndërmarrë nga autoritetet rregullatore të rajonit anëtarë të EU-së, të cilat do të respektojnë afatin e vendosur (2012) për ta zbatuar. Gjatë këtij prezantimi u paraqitën çështjet lidhur me Solvency II (regjimet e ndryshme në Evropë, qeverisja e shoqërive, mbikëqyrja e grupeve, sensitiviteti ndaj riskut në llogaritjen e kapitalit), sfidat që sjell zbatimi i Solvency II, ndikimi në ekonomi i saj dhe Basel III, si dhe ndikimi në produktet e sigurimit.

Në këtë seminar iu kushtua vëmendje edhe metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë rrisht. Gjatë prezantimit u trajtuan sfidat me të cilat përballen autoritetet rregullatore të rajonit në zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë rrisht. Përfaqësuesit e autoriteteve rregullatore të rajonit cilësuan si sfida kryesore: ngritjen e kapaciteteve të stafit në drejtim të njohurive dhe ekspertizës në mbikëqyrjen me bazë rrisht; mbështetjen e kësaj metodologjie mbikëqyrjeje me një infrastrukturë të nevojshme, ndryshimet e nevojshme në bazën rregullatore për të mbështetur metodologjinë e re të mbikëqyrjes dhe zbatimin e Direktivës për Solvency II, etj.

### **Zhvillohet konferenca ndërkombëtare mbi sistemet informative mbikëqyrëse “TI, masat, metodat e mënyrat e matjes së sigurtisë informative”**

*Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Estonisë (FSA Estonia), zhvilloi gjatë periudhës 5-6 maj, në Tallinn, Estoni, konferencën ndërkombëtare mbi sistemet informative mbikëqyrëse “TI, masat, metodat e*

*mënyrat e matjes së sigurtisë informative”.*

Ndër temat kryesore që u diskutuan gjatë ditës së parë, përmendim: Sfidat e mbikëqyrjes TI- analiza krahasuese: çfarë mund të përmirësohet dhe praktikatat e vlerësimit, metodologjitë e vlerësimit të rrisht dhe sistemet matëse, etj. Gjatë ditës së dytë u diskutuan tematikat e mëposhtme: strategjia dhe politika me orientim nga biznesi tek TI, praktikatat e transferimit të detyrave jashtë strukturës së organizatës për llogari të organizatës, kur pala e kontraktuar ndodhet brenda vendit dhe përtej kufijve të vendit, praktikatat drejt zbatimit në industrinë financiare, etj.

Qëllimi i konferencës ishte diskutimi mbi auditin dhe mbikëqyrjen me bazë rrisht, si dhe praktikatat më të mira për zhvillimin e një procesi mbikëqyrës sa më rezultativ.

Praktikat: Komunikim i vazhdueshëm me subjektet:

- o takime të vazhdueshme, mbi tematika të veçanta lidhur me palën e interesuar (subjektin e mbikëqyrur) dhe raporte statistikore të gjeneruara nga pala menaxheriale;
- o përdorimi i portaleve web (jo rrjeta-social) për një komunikim sa më interaktiv dhe të shpejtë midis palëve, mbikëqyrës-subjekt i mbikëqyrur;
- o takime që nxisin ndërgjegjësimin dhe përkushtimin e palëve të përfshira.

Mbikëqyrje sa më të gjerë:

- o zhvillimi i aktiviteteve me bazë mbikëqyrje të tipit “on-site” dhe “off-site”;
- o zhvillimi i sistemeve raportuese;
- o përmirësimi i raporteve të gjeneruara nga audit i jashtëm dhe i brendshëm;
- o ndërtimi i formularëve “Test” mbi tematika të ndryshme në lidhje me subjektet e ndikuara;
- o mbështetja tek standardet e industrisë.

Monitorim i vazhdueshëm i subjekteve:  
o monitorimi i profileve me bazë rrisht;

- o zhvillimi i sistemeve për matje të riskut;
- o imponimi i mënyrave të matjes dhe praktikave ;
- o krahasimi me bazë territori dhe orientimi;
- o zhvillimi i raporteve të strukturuar për eprorët.

Zhvillimi i njohurive të avancuara dhe investim mbi punonjësit:

- o praktikat e certifikimit dhe orientimit në aftësi të specializuara, në fusha të caktuara;
- o ndarja e njohurive brenda grupit;
- o ndërtimi dhe lançimi i pyetësorëve;
- o zhvillimi i konferencave nacionale dhe internacionale;
- o kooperimi me palë të treta të interesuara mbi tematikën e mbikëqyrjes.

Konsulenca si mjet i domosdoshëm:

- o konsulencë me të gjithë pjesëmarrësit para se të ndërmerret ndikimi në sistemin financiar nga rregullatori;
- o grumbullimi i mendimeve nga palët e treta nëpërmjet konsulencës;
- o vendimmarrje në ndryshime operationale;
- o ndërlidhjet internacionale;
- o komunikimi i vendimeve tek supervizorët;
- o standardet dhe udhëzimet.

### **Informacion mbi të rejtat në tregjet e rajonit Krijohet shoqëria e re e sigurimit të jetës në Maqedoni, Uniqa Life Macedonia**

Shoqëria e Sigurimit Uniqa ka krijuar një shoqëri të re sigurimi jete, **Uniqa Life Macedonia**, e cila do të ofrojë produktet e sigurimit të jetës në tregun e Maqedonisë.

Shoqëria mori një licencë, së fundmi, nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve e Republikës së Maqedonisë. Themeluesi i Uniqa Life Macedonia është Sigal Uniqa Group Austria, Tiranë, Shqipëri.

Trendi rritës i kapitalit të huaj në sektorin e sigurimeve në Maqedoni, stimulon konkurrencën dhe promovimin e produkteve të reja në treg, si

dhe përmirësimin e njohurive për menaxhimin e riskut dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Sipas licencës së dhënë, shoqëria do të kryejë biznesin e saj në tre klasat e sigurimit si me poshtë:

- 1- Sigurimi i Jetës;
- 2- Sigurimi i Aksidenteve;
- 3- Sigurimi Shëndetësor.

Sot, në tregun e sigurimit të Maqedonisë, janë të pranishme 4 shoqëri të sigurimit të Jetës dhe 11 shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës.

## **Edukimi i konsumatorit**

### **Metodikë për identifikimin e institucioneve me peshë në sistemin financiar (Systemically Important Financial Institutions-SIFI) në fushën e sigurimeve**

*Kontribut për diskutimet e Bordit të Stabilitetit Financiar dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e Shoqatës së Gjenevës "The Geneva Association", prill 2011)*

*Vijon nga numri I kaluar...*

## **4. Qasja e propozuar**

Në këtë kapitull prezantohet qasja e Shoqatës së Gjenevës, e mbështetur nga sektori i sigurimeve, për të sqaruar ndërlidhjen midis rregullimit makro dhe mikro, në mënyrë që të identifikohen aktivitetet që mund të mbartin risk për sistemin dhe në një fazë të dytë të identifikohen institucionet financiare të rëndësishme për sistemin të cilat i kryejnë këto aktivitete<sup>1</sup> (siç ilustruhet në tabelën e mëposhtme).

<sup>1</sup> Patrick Parkinson, Zëvendës drejtor i Degës së Kërkim-Statistikave pranë Bordit të Rezervës Federale, përshkruante një "plan loje" se si të vlerësohej vullneti dhe domosdoshmëria për ta shpëtuar bankën "Lehman Brothers" në muajin gusht 2008 me (1) identifikimin e aktiviteteve të bankës "Lehman" që mund t'i dëmtonin ndjeshëm tregjet financiare dhe ekonominë po që se çelte procedurën e falimentimit, (2) mbledhjen e informacionit për t'i vlerësuar me më shumë saktësi pasojat e mundshme të falimentimit të saj dhe (3) identifikimin e masave për zbutjen e riskut për fushat me rrezik të madh dëmi (Komisioni Kombëtar për Shkaqet e Krizës Financiare dhe Ekonomike në SHBA, 2011).





Faza e parë duhet të zhvillohet nga organet makro-mbikëqyrëse, me rolin e tyre të monitorimit të tregjeve dhe produkteve. Faza e

dytë duhet të zhvillohet nga entet mbikëqyrëse kombëtare dhe entet mbikëqyrëse të grupeve, kur ka, me funksionin e tyre mbikëqyrës.

**Tabela 2: Qasja e propozuar me dy faza**

Faza 1
- Identifikimi i aktiviteteve që mund të mbartin risk për sistemin dhe tregjeve përkatëse
- Zbatimi i kritereve të BSF/IAIS-së për të vlerësuar të gjitha aktivitetet e sigurimeve
- Zbatimi i kritereve të madhësisë, ndërlidhjes, zëvendësueshmërisë dhe kohës
- Përdorimi i treguesve cilësorë dhe sasiorë
- Marrja në konsideratë e kushteve të jashtme të tregut

Faza 2
- Identifikimi i institucioneve të angazhohen në aktivitete që mund të mbartin risk për sistemin në një shkallë kaq masive saqë dështimi ose ndërprerja e tyre mund të shkaktojnë krisje të sistemit
- Zbatimi i kritereve të BSF/IAIS-së për të vlerësuar institucionet
- Zbatimi i kritereve të madhësisë, ndërlidhjes, zëvendësueshmërisë dhe kohës (për aktivitet)
- Përdorimi i treguesve cilësorë dhe sasiorë
- Marrja në konsideratë e faktorëve rëndues dhe lehtësues

Kërkimi i një arkitekture të përshtatshme mbikëqyrëse për:

- procesin e identifikimit
- mbikëqyrjen e institucioneve financiare të identifikuara, të rëndësishme për sistemin

Për zhvillimin e të dyja fazave kërkohet një arkitekturë mbikëqyrëse e duhur. Procesi kërkon studimin e rrethanave të institucioneve të veçanta dhe duhet t'u japë një rol të fuqishëm enteve që mbikëqyrin grupet e shoqërive.

Në rubrikat në vijim jepen hollësi të mëtejshme për të dyja fazat.

#### 4.1 Faza 1: Identifikimi i aktiviteteve që mund të mbartin risk për sistemin

Sikurse shpjegohet në kapitullin 3<sup>2</sup>, kriteret e BSF/IAIS-së duhen zbatuar për aktivitetet me risk

dhe jo për institucionet (siguruesit dhe risiguruesit) në tërësi.

Në fazën 1 të qasjes së propozuar, identifikohen aktivitetet që mund të mbartin risk për sistemin. Këtë do të pritej ta luante IAIS, me rolin e saj si një institucion makroprudencial. Të gjitha aktivitetet që kryejnë siguruesit shqyrtohen duke përdorur kriteret e BSF/IAIS-së të madhësisë, ndërlidhjes, zëvendësueshmërisë dhe kohës. Nëse përmbushen të katër kriteret, atëherë aktiviteti duhet të kategorizohet si aktivitetet që mund të mbartë risk për sistemin.

Është e rëndësishme të shikohet çdo aktivitet më vete, në kuadër të kushteve ekzistuese të tregut. Për rrjedhojë, duhet përcaktuar një paketë e

<sup>2</sup> Shih periodikun e AMF-së, nr. 42, prill 2011, faqe 15-16

ndryshme treguesish, për matjen e riskut të mundshëm për sistemin të secilit aktivitet dhe treg. Kjo paketë treguesish duhet të hartohet në mënyrë të atillë që të tregojë kur ka një tronditje

në një faktor lëvizës të veçantë të aktivitetit. Në veçanti, përkufizimi i pragjeve për treguesit sasiore duhet të bëhet duke marrë në konsideratë kushtet ekzistuese të tregut.

**Tabela 3: Gjithësia e aktiviteteve të sigurimeve**



- A** Investimi i investimeve të policëmbajtësve dhe aksionerëve si mjete monetare ose përmes instrumenteve derivative
- Administrim aktive-pasive dhe shpërndarje strategjike e aktiveve
  - Aktivitete me instrumente derivative për bilanc jo sigurimesh

- B** Aktivitet tradicional sigurimi i krijimit të pasiveve duke ofruar mbrojtje/garanci
- Nënshkrim rrisht katastrofe
  - Nënshkrim i rrishtve afatgjatë
  - Shkrim biznesi me opsione riblerjeje
  - Shkrim i biznesit të jetës me garanci të trupëzuara

- C** Kalim rrisht sigurimi dhe tregu te të tretët
- Mbrojtje me instrumente derivative
  - Risigurim dhe retrocedim
  - Letra me vlerë dhe instrumente derivative të lidhura me sigurime

- D** Gjetje kapitali, financim afatshkurtër dhe afatgjatë, administrim likuiditeti për operacionet e administrimit të investimeve dhe krijimit të pasiveve
- Aktivitete të lidhura me thesarin
  - Gjetje kapitali afatgjatë

- E** Shitja e mbrojtjes ndaj rrishtit të kreditit
- Sigurim i kreditit
  - Garanci financiare
  - Shkrim instrumenti të kalimit të rrishtit të mosshlyerjes së kredisë

Krahas treguesve sasiore, duhen përcaktuar edhe treguesit përkatës cilësorë. Faktorët rëndues dhe lehtësues mund të ndikojnë në rrezikshmërinë e një aktiviteti të caktuar, për sistemin. Në konsideratë duhet të merren specifikat e tregut, specifikat e sigurimeve, kushtet ekonomike dhe trajtimi rregullator i aktivitetit.

Raporti i muajit mars 2010 me titull “Risku i sistemit në fushën e sigurimeve”, nga Shoqata e Gjenevës, përmbyllte fazën 1 duke i analizuar të gjitha aktivitetet e siguruesve për rrezikshmërinë e mundshme të tyre për sistemin. Konstatimet kryesore paraqiten më poshtë, ndërsa informacion më i hollësishëm mund të merret në raportin origjinal.

Sikurse paraqitet në tabelën 3, shoqëritë e sigurimeve mund të angazhohen në shumë aktivitete të ndërlidhura. Në bazë të këtyre kategorive aktivitetesh, raportin nxjerr një listë aktivitetesh specifike të cilat janë të ndërlidhura me pjesë të tjera të sistemit financiar dhe të cilat, për rrjedhojë, duhen vlerësuar për potencialin e krijimit të riskut për sistemin.

Disa prej aktiviteteve, siç janë krijimi i pasiveve, administrimi i investimeve, administrimi i kapitalit, financimit dhe likuiditetit, risigurimi dhe aktivitetet e tjera të kalimit të riskut, brenda kësaj gjithësie përbëjnë aktivitetet “qendrore” të sigurimeve në të cilat janë të angazhuara thuajse të gjitha shoqëritë e sigurimeve. Mirëpo, disa aktivitete nuk i kryejnë të gjithë siguruesit. Ndërsa, disa të tjera janë e shumta në periferi të biznesit për thuajse të gjithë siguruesit. Këto mund të konsiderohen si aktivitete “jo qendrore”.

Raporti arrin në përfundimin se asnjëri prej aktiviteteve qendrore të sigurimeve nuk sjell risk për sistemin duke qenë se asnjëri prej këtyre aktiviteteve nuk i përmbush të katër kriteret e vendosura nga BSF dhe IAIS. Mirëpo, janë identifikuar dy aktivitete jashtë biznesit qendror të sigurimeve, të cilat mund të përbëjnë risk për sistemin, dhe të cilat janë spekulimi me

instrumentet derivative/dorëzanitë financiare dhe keqadministrimi i aktivitetit të financimit afatshkurtër nëse kryhet në shkallë të madhe dhe me mbikëqyrje të papërshtatshme të riskut. Këto dy aktivitete diskutohen më me hollësi më poshtë.

#### **4.1.1 Spekulumi me instrumentet derivative/dorëzanitë financiare**

Aktiviteti i parë që ka identifikuar raporti i muajit mars 2010 si aktivitet që mund të ketë risk për sistemin (çka është konfirmuar kohët e fundit në një rishikim të aktiviteteve të kryera nga siguruesit)<sup>3</sup> është spekulimi me instrumente derivative/dorëzanitë financiare.

Është e rëndësishme të veçohet aktiviteti spekulativ nga çdo aktivitet tjetër i mbrojtjes që përdor instrumentet derivative për t'u mbrojtur nga risku i tregut dhe për të trajtuar luhatjen e vlerave të aktiveve. Përdorimi i instrumenteve derivative nga subjektet siguroese të rregulluara është shumë i shtrënguar në të gjitha juridiksionet kryesore. Në këto juridiksione instrumentet derivative mund të përdoren vetëm për të zvogëluar profilin e riskut të siguruesit ose për të administruar me efikasitet portofolin sidomos kur tregjet e instrumenteve derivative janë më likuide se tregjet për aktivitet e barasvlershme në mjete monetare.

Mirëpo, siguruesit mund të kryejnë edhe veprime të tjera me instrumente derivative krahas atyre për mbrojtje. Faktori i rëndësishëm është se ky aktivitet kufizohet brenda bilanceve që nuk u përkasin sigurimeve dhe shpesh zhvillohet në juridiksione pa një regjim të efektshëm të mbikëqyrjes së grupit. Një aktivitet i tillë spekulimi nëse bëhet për qëllime fitimprurëse dhe realizohet në një shkallë të madhe dhe pa administrimin e duhur të riskut ose pa një mbikëqyrje rregullatore ka potencialin për të

<sup>3</sup> Përmes Grupit të Punës për Stabilitetin Financiar të Shoqatës së Gjenevës organizohen diskutime të rregullta për problemet e riskut të mundshëm për sistemin në këtë sektor të ekonomisë.

transmetuar me shpejtësi humbje të ndjeshme përtej subjektit të përfshirë në to, në sektorin e gjerë financiar. Duhet konsideruar se mund të ketë rëndësi për sistemin duke qenë se kërkesat për ekzekutimin e këtyre instrumenteve derivative mund t'i kapërcejnë me shpejtësi burimet likuide financiare të librave shumë të mëdhenj të tregtimit gjatë kushteve të skajshme të tregut. Këto pozicione jo medoemos zbulohen gjatë vlerësimeve të brendshme të kapitalit ekonomik të siguruesve, dhe për to nuk ka mbikëqyrje të mjaftueshme.

Ky aktivitet përfshin edhe dorëzanitë financiare që ofrojnë shoqëritë financiare me një linjë aktivitetesh, për rritjen e kredisë të emetuesve të obligacioneve. Megjithëse dorëzanitë financiare janë të vogla sa u takon primeve, ato mbulojnë 2.3 trilionë dollarë amerikanë në aktive financiare.<sup>4</sup> Për këtë, janë tejet të lidhura me ekonominë reale dhe me bankat e mëdha që kanë marrëdhënie të ndjeshme me institucionet financiare me një linjë aktivitetesh.

Modelet tregtare të institucioneve me një linjë aktivitetesh ndryshojnë nga modelet e siguruesve të tjerë nga portofolat e tyre tejet të përqendruar dhe jo të diversifikuar, nga raportet e larta të borxhit dhe nga varësia ekstreme të kategorizimi i kredisë së tyre. Këto tipare nënkuptojnë që ulja e kategorisë vlerësuese të institucioneve me një linjë aktivitetesh mund të ketë ndikim në gjithë sistemin, duke i shtrënguar investitorët ta zvogëlojnë riskun e tyre ose të angazhojnë (befas) më shumë kapital për mbajtjen e aktiveve me kategori më të ulët vlerësuese. Vlerësimi sipas tregut i këtyre letrave me vlerë nënkupton që humbjet mund të transmetohen thuajse në çast.

#### 4.1.2 Keqadministrimi i financimit afatshkurtër

Aktiviteti i dytë me risk të mundshëm për sistemin është keqadministrimi i financimit

afatshkurtër. Disa sigurues e shfrytëzojnë kategorinë e lartë vlerësuese të tyre dhe kapacitetin huamarrës për të gjetur fonde afatshkurtra duke përdorur, për shembull, dëftesa tregtare dhe i investojnë të hyrat në aktive që ofrojnë kthim më të lartë, duke krijuar mundësinë që të fitojnë një marzh si fitim.

Siguruesit mund të japin hua letra me vlerë edhe nga portofolat e tyre të mëdhenj të investimeve personave që merren me shitje të shkurtër dhe të ri-investojnë kolateralin. Kur risku i likuiditetit mbahet në kontroll, risqet e mbetura nga kjo linjë aktiviteti janë të vogla, duke u dhënë mundësi siguruesve të nxjerrin një fitim më të madh për mbajtësit e policave dhe aksionarët e tyre.

Është e rëndësishme të thuhet se duke pasur parasysh pozicionin e gjatë të likuiditetit të një siguruesi, aktivitete të tilla mund të jenë të arsyeshme dhe me fitim. Nëse monitorohen mirë, ato nuk duhen ndaluar duke qenë se u ofrojnë likuiditet tregjeve dhe, në fund, u ofrojnë një kthim më të mirë shoqërive dhe klientëve të tyre. Problemi është vetëm atëherë kur këto aktivitete kryhen në masë, me një administrim jo të mirë likuiditeti, duke përdorur ndjeshëm borxhin, dhe atëherë kur kolaterali keqadministrohet. Në raste të tilla ka mundësi që burimet financiare likuide maksimale të siguruesit të mos mjaftojnë në një krizë likuiditeti.

Këto aktivitete (financime afatgjata me dëftesa tregtare dhe huadhënia e letrave me vlerë) janë aktivitete të arsyeshme të cilat një sigurues mund t'i kryejë për të përmirësuar kthimet që nxjerrin për mbajtësit e policave dhe aksionarët. Nëse keqadministrohen, të dy aktivitetet kontribuojnë në të njëjtin risk: pra në riskun që siguruesi ka marrë mjete monetare me maturim shumë të shkurtër, i investon mjetet në aktive që janë më pak likuide dhe pastaj zbulon se ky burim financimi avullon. Shitja e detyruar e aktiveve, në kushte të këqija tregu, mund t'i ulë vlerat e aktiveve, duke i përkeqësuar më tej

<sup>4</sup> Swiss Re (2006).

humbjet.

Është e vështirë të konceptohet se si një sigures mund ta keqadministrojë bilancin e tij për të krijuar një risk likuiditeti që është aq i madh sa të përbëjë një rrezik me vlerë materiale për sistemin e gjerë financiar. Megjithatë, nuk mund ta vërtetosh me siguri absolute se kjo nuk mund të ndodhë asnjëherë në asnjë rrethanë. Në rrethana ekstreme, financimi afatshkurtër me dëftesa tregtare dhe dhënia hua e letrave me vlerë në masë, me një kolateral të keqadministruar, mund të jetë me risk për sistemin.

#### **4.2 Faza 2: Identifikimi i institucioneve financiare që mund të jenë të rëndësishme për sistemin**

Një institucion financiar që mund të jetë i rëndësishëm për sistemin është ai institucion i cili realizon një sasi të konsiderueshme aktiviteteve me risk për sistemin. Pasi identifikohen aktivitetet me risk për sistemin, në fazën 1, mbikëqyrësit kombëtarë (ose mbikëqyrësit e grupeve, kur ka) duhet ta ushtrojnë autoritetin e tyre mbikëqyrës për të identifikuar institucionet financiare të rëndësishme për sistemin në një fazë të dytë. Analizohet roli i çdo siguresi të veçantë në treg për aktivitetin përkatës, duke përdorur kriteret e BSF/IAIS-së, me tregues që janë specifik për aktivitetet.

Duhet përcaktuar në nivel institucional një paketë treguesish të përshtatshëm cilësorë dhe sasiorë për aktivitetet e identifikuar. Institucionet financiare që mund të jenë të rëndësishme për sistemin dhe që kryejnë aktivitete që mund të mbartin risk për sistemin duhet të identifikohen në bazë të treguesve të përcaktuar. Kjo analizë duhet të zhvillohet në nivel grupi të agreguar.

Edhe pse disa tregues mund të jenë shumë të saktë dhe tërheqës nga një këndvështrim

konceptual, është e rëndësishme që të mund të maten me siguri dhe realizueshmëri të mjaftueshme. Kështu që, gjatë përcaktimit të treguesve duhet mbajtur parasysh sa mund të gjenden të dhënat (për shembull, nga burimet publike, nga mbikëqyrësit vendorë, nga vetë shoqëritë).

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen tregues që janë specifikë për aktivitetin në fjalë. Si shembull, nuk do të ishte mirë përdorimi i madhësisë së siguresit ose përhapjes së tij globale si tregues i një institucioni me rëndësi për sistemin, sepse do të jepte mesazhin e gabuar për reputacionin te palët e interesuara, duke qenë se diversifikimi në një portofol të madh sigurimesh përbën një burim fuqie për një sigures, dhe jo dobësie.

Sipas metodikës së propozuar me dy faza, duhen përcaktuar tregues specifikë për dy aktivitetet e identifikuar më parë që mund të përbëjnë risk për sistemin. Shoqata e Gjenezës propozon një paketë treguesish të zbatueshëm dhe aktualë, të cilët mund të shtjellohen më tej në bashkëpunim me mbikëqyrësit e grupeve të shoqërive dhe me sektorin në fjalë.

#### **4.3 Faktorët rëndësues dhe lehtësues**

Faktorët përkatës që e rëndojnë ose e lehtësojnë riskun e një institucioni duhen mbajtur në konsideratë si pjesë e procesit të identifikimit të riskut për sistemin, duke përfshirë elementet themelore siç janë kushtet e tregut. Gjithashtu, faktorë kritikë të cilët duhen mbajtur parasysh janë edhe faktorë të tillë lehtësues si administrimi i brendshëm i riskut i një institucioni ose fushëveprimi i mbikëqyrjes (si në rastin e mbikëqyrjes së plotë të grupit të shoqërive). Trajtimi rregullator duhet të përbëjë një pjesë integrale të vlerësimit. Nëse ekzistojnë faktorët e duhur lehtësues në nivel institucional, atëherë një institucion me zbulim të konsiderueshëm në treg përmes një aktiviteti me risk të mundshëm për sistemin nuk duhet të

klasifikohet si institucion financiar me rëndësi për sistemin.

Në rastet kur institucioni e ka sistemin e duhur të brendshëm të kontrollit të riskut, merr kolateral të mjaftueshëm dhe likuid ose vepron nën mbikëqyrje të përshtatshme, atëherë risku që mbart për sistemin aktiviteti që kryen institucioni mund të zvogëlohet ndjeshëm, madje poshtë nivelit në të cilin do të shkaktonte shqetësime për sistemin.

*Vijon në numrin tjetër...*

***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, T. Baleta, V. Theodhori,  
A. Dervishi, D. Papalilo, K. Dervishaj,  
Dh. Hazbiu, E. Kodra, E. Sherri, F. Broqi,  
R. Eltari, E. Kokona

